

VAKSINIMI KUNDËR HPV OSE PAPILOMAVIRUSIT NJERËZOR



Kjo vaksinë është shumë e rëndësishme për të mbrojtur fëmijën tim kundër HPV.

Për vajzat dhe djemetë që në moshën 11 vjeç
Kjo vaksinë nuk është e detyrueshme por këshillohet veçanërisht.




HPV, Ç'JANË ?

HPV janë viruse të njeriut të quajtur **papilomavirus**.

HPV janë të shumtë.


Ekzistojnë rreth 200 papilomavirus të ndryshëm.



HPV janë shumë ngjitës:

Kjo do të thotë që ata transmetohen lehtësisht nga një person tek tjetri.

Shumë individë e kanë këtë virus brenda vetes.



Virus HPV transmetohen shpesh gjatë mardhënieve të para seksuale.

Prezervativi nuk mbron plotësisht kundër HPV.

Në shumicën e rasteve trupi ynë i eliminon këto viruse.


Por kur nuk e eliminon trupi ynë, virusi mund të shkaktojë:

- Dëmtime (plagë) para-kanceroze, Domethënë kur nuk është shfaqur ende kanceri,
- kancer,
- lythë anogjenitale.

Lythët shfaqen në zonën e anusit dhe të seksit. Ata nuk janë të rrezikshëm por japin dhëmbje.




Çdo njeri mund të ketë plagë parakanceroze, kancer dhe lythë, si burrat edhe gratë.



Cdo vit në Francë, HPV shkaktojnë:


- 100 000 lythë
- 6 400 raste të reja të kancerit

**VAKSINA KUNDËR HPV ËSHTË NJE
MEDIKAMENT QË MBRON. AJO ËSHTË E
SIGURT.**



Vaksina kundër HPV mbron fëmijën tuaj kundër:


- Plagëve parakanceroze dhe/ose kancerit:
 - të qafës së mitrës,
 - të vulvës,
 - të vaginës,
 - të anusit,
- lythëve anogjenitalë.



Vaksina kundër HPV është efikase dhe pa rrezik.

Mbi 100 milionë fëmijë janë vaksinuar deri tani në botë.

NË Ç'MOSHË DUHET TA VAKSINOJ FËMIJËN ?





Vaksina këshillohet duke filluar nga moshja 11 vjeç dhe deri në moshën 14 si për vajzat dhe për djemtë.

Sa më herët të vaksinohet fëmija juaj, aq më shumë vakcina e mbron kundër sëmundjeve.

Duhet **2 doza vaksine** për të qënë i mbrojtur.

Mos harroni injeksionin e dytë, 5 deri në 13 muaj më vonë.


MUAJI 1 	MUAJI 2	MUAJI 3	MUAJI 4
MUAJI 5	MUAJI 6 	MUAJI 7	MUAJI 8
MUAJI 9	MUAJI 10	MUAJI 11	MUAJI 12

Fëmija juaj mund të marrë njëkohësisht:

- një dozë të vaksinës kundër HPV,
- një tjetër vaksinë, për shembull vaksinën përforcuese dTcaP.

Përforcimi e vaksinës dTcaP është parashikuar midis moshës 11 dhe 13 vjeç. DTcaP është vakcina kundër difterisë, tetanosit, kollës së mirë dhe poliomielitit.

PO TË KEM HARRUAR TË VAKSINOJ FËMIJËN ?






15 vjeç → 19 vjeç

Vaksinimi është ende i mundshëm midis moshës 15 dhe 19 vjeç.

Atëhere duhen **3 doza vaksine** për të qënë i mbrojtur.

Mos harroni injesionin e dytë dhe të tretë, dy dhe 6 muaj pas injeksionit të parë.

MUAJI 1 	MUAJI 2	MUAJI 3 	MUAJI 4
MUAJI 5	MUAJI 6	MUAJI 7 	MUAJI 8
MUAJI 9	MUAJI 10	MUAJI 11	MUAJI 12

KUSH MUND TË VAKSINOJË FËMIJËN TIM ?



Një mjek



Një farmacist



Një mami



Një infermier



Mund të shkoni edhe në një qendër vaksinimi.

SA KUSHTON ?

Kasa e sigurimeve shoqërore rimbursen 65 % të çmimit të çdo doze të vaksinës.

Për shembull, për 100 €, sigurimet shoqërore ju kthejnë 65 €. Pjesën tjetër mund t'ju a kthejë mbrojtja shëndetësore plotësuese.



BENEFICIAIRE - NOM - PRENOM		PFAK		CENT		ALUM		LARA		EKTE		COBL		TRAN		HOCF		HOSD		CHAM		OBSQ	
SERIE DE RESERVANCE - N° SECURITE SOCIALE		SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH	SPH	CPH
XXXXXX	XXXX	123456789	12	P22017	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)	(16)	(17)	(18)	(19)
XXXXXX	XXXX	123456789	12	P22017	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)	(16)	(17)	(18)	(19)
XXXXXX	XXXX	123456789	12	P22017	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)	(16)	(17)	(18)	(19)


Vaksinimi është falas:

- Në shkollën tetëvjeçare, për nxënësit e klasës së 5^{të},
- në disa qendra vaksinimi të qytetit tuaj apo të rrethit tuaj,
- nëse keni Mbrojtjen plotësuese Santé Solidaire ose ndihmën mjekësore të shtetit.

FËMIJA JUAJ ËSHTË NË KOLEGJ, NË KLASË TË 5^{TE}

Me autorizimin tuaj, fëmija juaj mund të vaksinohet në shkollë :

- nga një mjek,
- nga një farmacist,
- nga një mami,
- nga një infermier.



Fëmija juaj do të vaksinohet 2 herë.
Duhet të pajiset me librezën e shëndetit.
Vaksinimi është falas.



Nëse fëmija juaj e ka bërë injeksionin e parë të vaksinës, ai mund të bëjë injeksionin e dytë në kolegji.

Në 2023, 400 000 të rinj të moshës 12 vjeç u vaksinuan.

PËR TË DITUR MË SHUMË

Flisni me mjekun tuaj ose vizitoni websitin e-cancer.fr




PËR TË FOLUR ME FËMIJËN TUAJ

Takohemi në faqen tonë të posaçme preventionenfant.e-cancer.fr



PËR TË DITUR MË SHUMË MBI VAKSINIMIN

Shfletoni SantéBD-në e posaçme, që gjeni falas në www.santebd.org



Ilustrimet: ©SantéBD



Liflet FALC
I lehtë për tu lexuar dhe
kuptuar, i rilexuar nga persona
me të meta mendore ESAT l'Envol
(Unapei 34)

©Logo europiane E lehtë par tu lexuar: Përfshirja Europe. Për informacione të mëtejshme vizitoni Websitin www.easy-to-read.eu.